



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 67 Datë 26.03.2018

MBI

**PÛRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS
2018**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 84, pika 4 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, nenit 15 të “Rregullores për Organizimi, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.03.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për për muajin mars 2018,

Konstatoi se:

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 3818 Prot., datë 01.03.2018 (Protokolluar në ERE me Nr. 171/4 Prot., datë 05.03.2018), ka përcjellë në ERE aplikimin për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin mars 2018.
- Nga analiza që i’u bë aplikimit të OSHEE sh.a. mbi përcaktimin e përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, rezulton se sipas llogaritjeve të OSHEE sh.a çmimi për muajin mars 2018, është 7.74 lek/kWh.
- OSHEE, me gjithë komunikimet e vazhdueshme të zhvilluara në kuadër të procesit të nisur mbi miratimin e çmimit të shitjes për klientët e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për periudhën janar dhe shkurt 2018, nuk ka mundur të paraqesë informacion mbi koston

e disbalancave për njësi të energjisë së furnizuar në rolin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit edhe për muajin mars 2018

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.5 lekë/kWh për muajin mars 2018.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.